



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 947/ 16 prot.

Datë 19/06/2026

V E N D I M
Nr. 841/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19/06/2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 773/2026, datë 09.06.2026 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

Ankimues:

Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, me NIPT K72113010E, me adresë: Rruga “Mujo Ulqinaku”, Objekti Nr.23, Z.1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA)
Adresa: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9.

Subjekt i interesuar:

Operatori ekonomik “ZENIT&CO” SHPK me NIPT K61731002D dhe me adresë: Tiranë, Rruga "Myrteza Topi", Nd.18, Ap.38.

Operatori ekonomik “ARENA MK” SHPK me NIPT L67619801Q dhe me adresë: Ballsh Fier Ballsh, Fshati Ninësh Rruga Dames - Ninesh; Ndërtesa 4; Lagja “Memaj” Nj.Adm.Fratar, Bashkia Mallakastër.

Operatori ekonomik “NET-GROUP” SHPK me NIPT L72023002P dhe me adresë: Tiranë Rruga "Vorpset", pas restorant "Piazza", ZK 8350, Nr. Pasurie 6/187/N2.

Operatori ekonomik CIVIL CONS” SHPK me NIPT L81315015O dhe me adresë: Gjirokastrë, Lagjia “18 Shtatori” Rruga "18 Shtatori", Godinë 9 katëshe, kati 1-rë, objekti 15/5.

Operatori ekonomik “ERALD-G” SHPK me NIPT K36306784K dhe me adresë: Dibër Peshkopi, Herbel, Ndërtesa private Nr.61.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I**

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 09.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.773/2026, ku vendosi:

[...]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond

limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA)..

2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

1.2 Me shkresën nr. 3887 prot., datë 15.06.2026, protokolluar me tonën nr. 947/13 prot., datë 16.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 773/2026, datë 09.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3887 prot., datë 15.06.2026, protokolluar me tonën nr. 947/13 prot., datë 16.06.2026 autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 773/2026, datë 09.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të bëra në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet se autoriteti kontraktor nuk ka rivlerësuar me pikë sikurse është përcaktuar në pikën III.1.24.1, të vendimit Nr. 773/2026, datë 09.06.2026 ofertën e operatori ekonomik i ofertues “A & E ENGINEERING” SHPK, ofertën e operatori ekonomik i ofertues “ERALD-G” SHPK dhe ofertën e operatori ekonomik i ofertues “CIVIL CONS” SHPK përsa i përketë kriterit të vlerësimit “Përvoja për punë të ngjashme”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.3. Në nenin 24 pika 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit;”*.

Ndërsa në nenin 118 pika 2 e po këtij ligji parashikohet: *“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:*

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”

II.3.1. Nga interpretimi në tërësi i dispozitave ligjore të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të parashikuar nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe njëherazi përgjegjës për zbatimin e vendimeve të K.P.P. Gjykimi i themelit të çështjes gjatë vendimarrjes së organit kolegjial bazohet në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e fakteve, provave dhe materialeve të tjera të administruara gjatë shqyrtimit administrativ. Sa më sipër vendimarrja e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik përbën dhe zgjidhjen në thelb të çështjes nga njëra anë, si edhe efektin detyrues të saj për palët referuar dispozitivit të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe arsyen e vendimarrjes dhe eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE)

Komisioni konstaton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përse i përketë kriterit të vlerësimit “Përvoja për punë të ngjashme”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë përcaktimet e bëra nga ana e Komisionit Prokurimit Publik në pikën III.1.24.1, të vendimit Nr. 773/2026, datë 09.06.2026, në të cilën Komisioni ka gjykuar se në lidhje me këtë kriter kualifikues vlerësimi me pikë duhet të bëhet mbi bazën e vlerës totale të shërbimeve të ngjashme të realizuara nga këta operatorë ekonomik ofertues dhe konkretisht operatori ekonomik ofertues “NET-GROUP” SHPK ka dëshmuar se gjatë tre viteve të fundit nga publikimi i procedurës së prokurimit ka realizuar shërbime të ngjashme me vlerën më të madhe dhe konkretisht në vlerën 55.587.226,12 182 (pesëdhjetë e pesë million e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë presje dymbëdhjetë) leke pa TVSH, duke përfituar vlerësimin me 10 (dhjetë) pikë, ndërsa ofertuesi “A & E ENGINEERING” SHPK, ka dëshmuar se ka realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme përkatësisht në vlerën 45.404.013,05 (dyzet e pesë million e katëqind e katër mijë e trembëdhjetë presje zero pesë) leke pa TVSH, ofertuesi “CIVIL CONS” SHPK, ka dëshmuar se ka realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme përkatësisht në vlerën 31.078.197,99 (tridhjetë e një million e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje nëntëdhjetë e nëntë) leke pa TVSH, ndërsa ofertuesi “ERALD-G” SHPK, ka dëshmuar se ka realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të procedurës së prokurimit shërbime të ngjashme përkatësisht në vlerën, dhe 12.520.000 (dymbëdhjetë million e pesëqind e njëzet mijë) leke pa TVSH, ndaj dhe këta operatorë duhej të vlersoheshin me pikë në raport me përqindjen që zënë vlerat e shërbimeve të ngjashme të realizuara nga secili prej tyre në raport me vlerën e shërbimeve të ngjashme të realizuara nga operatori ekonomik ofertues “NET-GROUP” SHPK, dhe jo sikurse ka vlerësuar Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në rivlerësimin e datës 15.06.2026.

Për këtë arsye, Komisioni gjykon se, për rivlerësimin me pikë përse i përketë kriterit të vlerësimit “Përvoja për punë të ngjashme”, të përcaktuar në pikën 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” të Seksionit 4 “Procedura” të dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor duhet të lexojë me vëmendje interpretimet e Komisionit të Prokurimit Publik në pikën III.1.24.1, të vendimit Nr. 773/2026, datë 09.06.2026, duke ju referuar bazën ligjore, si dhe çdo referencë tjetër të cituar në këtë vendim.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike – Shërbime, Marrëveshje kuadër, me disa operator ekonomik, ku jo të gjithë kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-73472-12-29-2025 me objekt “Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2025” me fond limit: 29,083,172 (njëzet e nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë

pa TVSH, konvertuar në vlerën 301,504.99 (*treqind e një mijë e pesëqind e katër pikë nëntëdhjetë e nëntë*) euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 29.12.2025 (1 EUR = 96.46 Lekë), zhvilluar në datën 30.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST SHA).

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë plotësisht përcaktimet e pikës III.1.24.1,. të vendimit Nr. Nr. 773/2026, datë 09.06.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me rivlerësimin me pikë të ofertës së operatorëve ekonomikë “A & E ENGINEERING” SHPK, “CIVIL CONS” SHPK dhe “ERALD-G” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

